

## FTESË

Projekti “**Iniciativa për Qëndrueshmëri Ekonomike Rurale**” (RESI) fton të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës, që të marrin pjesë në **SESIONET INFORMATIVE** me qëllim të informimit të fermerëve në lidhje me mundësinë e aplikimit për grante që do të financohen nga projekti RESI i financuar nga Agjencioni Austriak për Bashkëpunim | (ADA).

### Takimet do të mbahen:

Data	Koha	Vendi
18.07.2017	09:30-11:30	Shkolla Fillore “Nexhmi Mustafa”-Prugovc
18.07.2017	13:00-15:00	Shtëpia e Kulturës-Keqekollë

Thirrja për propozime synon të mbështes grupet socio-ekonomikisht të cënueshme (fermerët e vegjël, të rinjtë e papunë dhe pakicat etnike të pafavorizuara), gratë (duke u dhënë prioritet familjeve me kryefamiljar femra) dhe shoqatat/kooperativat që i përfaqësojnë ato, me qëllim të rritjes së përfshirjes së tyre sociale dhe fuqizimin e tyre ekonomik.

Për këtë arsye, CARE/Projekti RESI fton të gjithë pjesëmarrësit e ligjshëm që janë të përfshirë në zhvillimin bujqësor dhe zhvillimin rural në Komunën e Prishtinës, që të marrin pjesë në sesionet informative për ftesën për propozime.

Sasia e përgjithshme e indikuar që do të jetë në dispozicion në ftesën për propozime është 356,000.00 EURO. Udhëzimet e plota për aplikuesit dhe për dokumentet tjera të nevojshme do të jenë në dispozicion në internet prej 14 Korrik 2017 në ueb-faqen e projektit: [www.resi-ks.org](http://www.resi-ks.org)